

Nga takimi i punës, iniciuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), midis anëtarëve të Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik në Kuvendin e Shqipërisë dhe përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Në datat 17-18 shtator u zhvillua në Shkodër takimi i punës mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Nënkomisionit të Auditimit të Sektorit Publik në Kuvendin e Shqipërisë (Nënkomisioni) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI).

Në këtë takim u vlerësua se, rritja e efektivitetit të bashkëpunimit midis Kuvendit dhe KLSH është thelbësore për sigurimin e mbikëqyrjes efektive parlamentare, të përdorimit të burimeve publike, duke rritur ndikimin e rekomandimeve të KLSH-së, si dhe ngritja e Nënkomisionit do jetë një ndër mekanizmat dhe nxitësit e thellimit të kësaj marrëdhënieje.

Nga përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë dhe përfaqësuesit e NDI, u vlerësua maksimalisht vendimmarrja e Kryetarit të KLSH-së, për ngritjen e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar, përgjegjshmëria dhe gatishmëria e KLSH për rritjen e nivelit të bashkëpunimit me Kuvendin.



Qëllimi i këtij takimi ishte finalizimi i Rregullores së Brendshme të Nënkomisionit dhe Planit të punës për sesionin e vjeshtës, si dhe “Kuptimi i rolit të KLSH-së” i cili u prezantua nga z. Alastair Swarbrick (SIGMA) dhe z. Lage Bende (NDI) referuar Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.

Nga përfaqësuesit e KLSH-së u shpreh gatishmëria për plotësimin e kërkesave, bashkërendimin e veprimtarisë me planin e punës së Nënkomisionit, si dhe dhënien e asistencës për anëtarët e Nënkomisionit, referuar fushëveprimit të tij, si dhe në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pavarësisë institucionale.

KLSH falënderon znj. Ana Kovacevic, Drejtore e NDI-Albania; ekspertët: z. Anthony Staddon (NDI), z. Lage Bende (NDI) dhe z. Alastair Swarbrick (SIGMA), për mundësimin e këtij takimi pune, si dhe për ekspertizën dhe eksperiencën e dhënë.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë si: Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Ekonominë dhe Financat z. Eduard Shalsi; anëtarët e Nënkomisionit të Auditimit në Sektorin Publik, znj. Emilia Koliqi (Kryetare), znj. Enslemvera Zake (Nënkryetare), z. Alban Xhelili, znj. Sorina Koti, znj. Pranvera Resulaj, dhe znj. Antoneta Dhima (anëtarë), si dhe znj. Alkida Llakaj, Drejtore e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga: znj. Brunilda Zeneli, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar; z. Bledar Mustafaraj, Drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. Alketa Çobo, znj. Kristina Pushi dhe znj. Paola Shera, audituese në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar.